



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.11.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KËSHILLIT TË PAVARUR
MBIKQYRËS TË SHËRBIMIT CIVIL TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të KPMSHCK-së në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Arian Haxha (Udhëheqëse Ekipi), dhe Laureta Matoshi (anëtare ekipi).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Qeverisja	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	22
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	23


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 24/11/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.


Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**)

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigje nga Menaxhmenti - auditimi i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet tona. Përveç çështjes nr.4 për më shumë shih Shtojcën 3.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

KPMSHCK ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara të Sekorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 06/2011.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200/1700 Opinioni i Pamodifikuar)
--

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

KPMSHCK duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullës Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Planin preliminar dhe final të prokurimit;
- Raportet për borxhet e papaguara; dhe
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€.

Në kontekst të PVF-ve dhe obligimeve tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

KPMSHCK-ja përkundër zotimit të dhënë ende nuk e kishte adresuar rekomandimin e dhënë në raportin e auditimit të PVF-ve për vitin 2013. Ne, shprehim shqetësimin tonë për këtë dhe inkurajojmë menaxhmentin për ndërmarrjen e veprimeve adekuate për adresimin e tij.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të KPMSHCK-së ka rezultuar me vetëm një rekomandim. KPMSHCK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohet rekomandimi i dhënë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, rekomandimi lidhur me përzgjedhjen e një operatori ekonomik për shërbime të telefonisë nuk ishte adresuar. KPMSHC gjatë 2014 kishte tentuar të lidhë kontratë përmes procedurave të prokurimit mirëpo në mungesë të operatorëve nuk kishte arritur marrëveshjen.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga KPMSHCK si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi siç kërkohet me procedurat për menaxhimin financiar dhe kontrollin; si dhe
- Raportimi i rregullt javor nga njsitë vartëse.

Kontrollet për shpenzimet të cilat realizohen përmes procedurave të prokurimit, menaxhimin e pagesave për këto shpenzime si dhe menaxhimin e pasurisë janë të forta dhe po zbatohen në mënyrë efektive. Përderisa kontrollet në procesin buxhetor kërkojnë vëmendjen e menjëhershme të menaxhmentit për të evituar shpenzimin e buxhetit të nënkategorive tjera për shpenzime të paplanifikuara. Në këtë aspekt, duhet t'i kushtoj vëmendje edhe limiteve buxhetore me qëllim që të mos hyj në obligime pa u siguruar paraprakisht se ka buxhet të mjaftueshëm.

Më tej, edhe kontrollet në paga dhe mëditje nuk ishin adekuate. Mënyra e pagesës për punën shtesë dhe pagesën retroaktive për ish anëtarin e Këshillit nuk ishin mirë të bazuara.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

KPMSHCK ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për tu siguruar që sistemi financiar funksionon si duhet. KPMSHCK ka një strukturë të thjeshtë organizative të udhëhequr nga Bordi Drejtues. Bordi përbëhet prej Kryesuesit dhe 6 anëtarëve. Linjat e raportimit janë të strukturuar mirë dhe funksionojnë mirëpo nuk janë shfrytëzuar në mnyrë efektive.

Rekomandimet

Çështja 2 - Proceset e llogaridhënies - Prioriteti i lartë

E gjetura Edhe përkundër raportimit të rregulltë të shpenzimeve nga njësit vartëse, ato nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efektive nga menaxhmenti për të evituar tejkalimin e buxhetit për nënkategorinë e udhëtimeve zyrtare dhe kompensimin e pagesës retroaktive për anëtarin e Këshillit (për më shumë shih nënkapitullin paga dhe mëditje).

Regjistri për menaxhimin e rrezikut nuk ishte hartuar nga KPMSHCK-ja i cili duhet t'i paraprijë procesit të identifikimit të rreziqeve dhe vlerësimit të tyre me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve në nivel të pranueshëm.

Rreziku Mos aplikimi i kontrolleve në mënyrë efektive nga Menaxhmenti rezulton në dobësi në procesin e shpenzimeve dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 1 Kryetari i Këshillit duhet të rishqyrtoj shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në planifikimin dhe realizimin e buxhetit për nënkategori si dhe kompensimeve (pagave dhe mëditjeve) dhe të sigurojë eliminimin e mangësive në këto fusha.

Po ashtu të siguroj se regjistrat e rrezikut hartohen dhe shfrytëzohen nga menaxhmenti si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për KPMSHCK-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	259,500	273,746	273,455	247,668	214,309
Granti i Qeverisë -Buxheti	259,500	273,746	273,455	247,668	214,309

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 14,246€. Rritjet kanë ndodhur në paga dhe meditje me vendim të qeverisë për rritje të pagave 25%, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime ishte zvogluar buxheti prej 15% me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore.

Gjatë vitit 2014, KPMSHCK -ja kishte shpenzuar 273,455€ apo 99.89% të buxhet final .

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	259,500	273,746	273,455	247,668	214,309
Pagat dhe Meditjet	193,351	207,519	207,519	183,687	151,994
Mallrat dhe Shërbimet	61,649	62,402	62,287	60,159	55,701
Shërbimet komunale	4,500	3,825	3,649	3,822	4,282

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për Paga dhe Meditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 14,168€ bazuar në vendimin e Qeverisë për rritje të pagave prej 25%. Buxheti final ishte shpenzuar në tërësi 100%.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

- Buxheti për Mallra dhe Shërbime fillimisht ishte zvogëluar për 9,247€ bazuar në vendimin e Qeverisë për kursime buxhetore prej 15%, dhe më pas ishte rritur për 10,000€ po ashtu me vendim të Qeverisë. Buxheti final ishte shpenzuar 99.8%.
- Buxheti final për Shërbime komunale ishte zvogëluar për 675€ bazuar në vendimin e Qeverisë për kursime buxhetore prej 15%. Reaklizimi në këtë kategori ishte 95.4% e buxhetit final.

Rekomandimet

Çështja 2 -Planifikimi dhe realizimi i buxhetit per mallra dhe shërbime -Prioritet i Lartë

E gjetura Nga buxheti për mallra dhe shërbime, 22,461€ apo 35% ishin shpenzuar për udhëtime zyrtare, përderisa buxheti i ndarë për udhëtime ishte 10,241€. Pjesa e tejkualuar e shpenzimeve ishte financuar nga buxheti i nënkategorive tjera. Sipas KPMSHC-së arsyeja e tejkalimit të shpenzimeve për udhëtime ishte kërkesa e Kuvendit të Kosovës për monitorimin e misioneve diplomatike.

Me vendim të qeverisë të datës 05/11/2014, buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 10,000€. Megjithatë, përkundër rritjes, shpenzimet kanë tejkualuar buxhetin e planifikuar, vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit ishte 2,536€.

Rreziku Devijimi nga planifikimi buxhetor duke mbishpenzuar njëren nënkategori (shpenzimet e udhëtimit) në dëme të nënkategorisë tjetër mund të vështirësoj kryerjen e obligimeve financiare të planifikuara me planin vjetor të buxhetit.

Rekomandimi 2 Kryetari i Këshillit duhet të siguroj se ka forcuar kontrollet buxhetore për të parandaluar tejkalimin e shpenzimeve të buxhetuara dhe krijimin e borxheve të pambuluara. Veç kësaj, para vendosjes për të shpenzuar gjithmonë duhet të sigurohet se ekziston buxheti i mjaftueshëm për financimin e atij shpenzimi.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Gjatë vitit 2014, KPMSHCK-ja përmes procedurave të prokurimit kishte shpenzuar 26,393€. Ne kemi testuar 14 mostra nga mallrat dhe shërbimet në vlerë prej 14,463€. Gjithashtu, për të vlerësuar nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik ne kemi testuar 3 aktivitete të prokurimit.

Ne kemi vërejtur se KPMSHCK-ja ka vendosur kontrole funksionale në realizimin e shpenzimeve, dhe kjo ka ndikuar që proceset e prokurimit të zhvillohen në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Rekomandim

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Nga testimi i shpenzimeve të cilat nuk realizohen përmes procesit të prokurimit kemi vërejtur se kontrollet sa i përket këtyre shpenzimeve kanë funksionuar mirë me përjashtim të shpenzimeve të telefonisë mobile.

Rekomandimi

Çështja 3 - Shpenzimet e telefonisë mobile pa procedura të prokurimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Ligji i Prokurimit Publik (LPP) Nr. 04/L-042 neni 1 kërkon të sigurohet mënyrë më efikase, më transparente dhe më e drejtë e shfrytëzimit të fondeve publike. Gjatë vitit 2014 KPMSHC-ja kishte shpenzuar 8,965€ për telefonin mobile. Furnizimi me mbushje ishte bërë nëpërmjet kartelave grithëse nga i njëjti operator ekonomik dhe pa ndonjë kontratë. E vlen të cekët që, gjatë 2014, KPMSHC ka zhvilluar procedurat e prokurimit por nuk ka arritur të lidhë kontratë në mungesë të ofertave.

Rreziku Sigurimi i mbushjeve të telefonave mobil nëpërmjet kartelave grithëse nga i njëjti operator ekonomik pa ndonjë kontratë ndikon që buxheti të mos shpenzohet në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Rekomandimi 3 Kryetari i Këshillit duhet të analizoj mënyrën e tanishme të sigurimit të shërbimeve të telefonisë mobile dhe të zgjedh mënyrën e cila institucionit i siguron shërbime më efikase dhe me kosto më të ulët. Meqenëse ofrimi i shërbimeve të telefonisë mobile bëhet nga disa operator ekonomik si alternativ mund të ishte zhvillimi i procedurave të prokurimit ku përmes konkurrencës së hapur mund të sigurohen kushte më të favorshme dhe të arrihet vlera për parane.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë nga KPMSHC-ja kanë të bëjnë llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe legjislacionit të aplikueshëm. Kontrollat kanë funksionuar mirë, megjithatë duhen ndërmarrë veprime shtesë për eliminimin e disa mangësive në këtë fushë.

Buxheti i planifikuar për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 207,519€. Buxheti ishte shpenzuar në tërësi (100%) gjatë vitit 2014.

Rekomandimet

Çështja 4 – Paguesa për punë jashtë orarit dhe pagesa retroaktive për punën e pakryer – Prioritet i lartë

E gjetura Kryetarja e Këshillit me datën 22.09.2014 kishte marrë vendim që tre (3) anëtarëve të KPMSHC-së si dhe vet Kryetares tu paguhen shtesat nga 525€ bruto në muaj për shkak të angazhimit të tyre jashtë orarit të punës. Sipas vendimit, kompensimi do të realizohet deri në zgjedhjen e tre anëtarëve të rinj të Këshillit. Kjo, sipas Këshillit ishte e nevojshme për shkak të rritjes së numrit të ankesave dhe mungesës së anëtarëve të tjerë.

Si rrjedhojë, shtesat e paguara për vitin 2014 janë në vlerë prej 10,500€.

Çështjet në vijim janë identifikuar:

- Kompensimi për punë shtesë për Këshillin paraprakisht do të duhej të aprovohej nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, në kohën e marrjes së vendimit, Kuvendi i Kosovës nuk ishte funksional. Kërkesa është dërguar në MAP dhe aty është cekur edhe konsultimi me MF-në.
- Puna jashtë orarit nuk ishte e dokumentuar edhe pse të gjitha ankesat ishin shqyrtuar brenda afatit ligjor.

E gjetura

Kuvendi i Kosovës me vendimin nr.03-V-149 me datën 23 korrik 2009 emëron anëtarin e KPMSHCK-së për një periudhë pesë vjeçare. Mirëpo anëtarja kishte filluar punën në KPMSHCK me datën 01 nëntor 2009 d.m.th tre muaj pas vendimit të Kuvendit të Kosovës. Pas skadimit të mandatit të anëtares së bordit, KPMSHCK-ja në muajin korrik 2014 i kishte paguar në mënyrë retroaktive vlerën prej 1,103€ për periudhën 23 korrik 2009 - 01 nëntor 2009, përkundër faktit që anëtarja nuk ka ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së cekur më lartë. Vlen të ceket, se kërkesa e njëjtë për kompenzim ishte parashtruar më parë në MAP, mirëpo ishte refuzuar nga ana e këtij të fundit me arsyetimin se anëtarja në fjalë nuk i ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë gjatë periudhës në fjalë.

Ne e kemi analizuar listën e pagave për vitin 2009 dhe anëtarja të cilës i është aprovuar kompensimi, në periudhën 23 Korrik 2009 deri më 1 Nëntor 2009 ishte duke punuar në Ministrinë e Financave dhe kishte përfituar pagë nga buxheti i Kosovës.

Rreziku

Pagesa pa i realizuar detyrat e punës dhe përgjegjësitë sipas vendimit të emërimit, si dhe kompenzimet për punë shtesë për anëtarët e bordit pa ndonjë plan paraprak lidhur me punën e nevojshme jashtë orarit dhe caktimi i shtesave fikse ndikon në dëmtimin e buxhetit.

Rekomandimi 4

Kryetari i Këshillit duhet të ndërmarrë veprime shtesë që në të ardhmen me rastin e nevojës për punë shtesë të merret aprovimi nga Kuvendi i Kosovës dhe po ashtu të siguroj që puna e kryer jashtë orarit dokumentohet.

Më tutje, Kryetari i Këshillit duhet të siguroj se ka iniciuar procedurat për kthimin e pagave nga ish anëtari i Këshillit të përfituara si pagesë retroaktive.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1000€) ishte 16,000€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale (nën 1000€) ishte 40,320€.

KPMSHCK-ja kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me kërkesat e rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të organizateve buxhetore. Regjistri i pasurisë ishte azhurnuar vazhdimisht nga zyrtari i pasurisë andaj regjistri ishte i plotë dhe i saktë lidhur me pasuritë që posedon. Po ashtu në përputhe me kërkesat e rregullores financiare në fund vit ishte bërë inventarizimi i pasurisë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 ishte në shumën 2,536€. Faturat për detyrimet e papaguara ishin për muajin dhjetor 2014 dhe i takonin kategorisë mallra dhe shërbime. Arsyeja e mos pagesës ishte mungesa e buxhetit, pasi që buxheti për këtë kategori ishte shpenzuar në tërësi (100%). Pra KPMSHCK kishte hyrë në obligime pa u siguruar paraprakisht se ka buxhet për kryerjen e obligimeve. Këto detyrime janë bartur për tu paguar në vitin pasues 2015.

Rekomandimet

Çështjet e ndërlidhura janë shpalosur paraprakisht tek çështja 2- planifikimi dhe realizimi i buxhetit.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, KPMSHCK-ja nuk i plotëson kushtet për themelimin e NjAB-së. Meqenëse KPMSHCK-ja nuk i plotëson kriteret për themelimin e NJAB-it, Auditimi i Brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF). Pasi që KPMSHCK konsiderohet organizatë me buxhet të vogël, DAB në kuadër të MF-së kryen një auditim të brendshëm çdo tri vite. Auditimi i fundit ishte kryer në vitin 2012.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Shpenzimet pa prokurim	Të monitoroj procesin e prokurimit deri në lidhjen e kontratës për shpenzime të telefonisë mobile. Lidhja e kontratës do të sigurojë shpezime me kosto më të ulët.			Nuk është adresuar

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e ZAP-it
E gjetura 4:	Jo	<p>Shtesat në pagë për anëtarët e Këshillit dhe bashkëpunëtorët profesional janë proceduar pas konsultimit me Ministrin dhe zv. Ministrin e Financave dhe me Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Administratës Publike. Ky konsultim është bërë duke pas parasysh faktin që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qenë jofunksional dhe që me rregullativen ligjore në fuqi nuk është përcaktuar saktë se cili organ vendos lidhur me shtesat e anëtarëve të institucioneve të pavarura.</p> <p>Shtesat për anëtarët e Këshillit janë përcaktuar në vlerë bruto 525 euro duke mos tejkaluar 50% e pages së anëtarit të Këshillit, ndërsa për bashkëpunëtorët profesional janë realizuar shtesat sipas rregullatives ligjore në fuqi për pagat dhe shtesat në pagë të nëpunësve civil.</p>	<p>Ne kemi marrë parasysh faktin që Kuvendi i Kosovës ishte jofunksional dhe po ashtu rritjen e ankesave për 2014. Po ashtu e kemi reflektuar që ankesat ishin shqyrtuar brenda afatit ligjor. Megjithatë, ne duhet t'a shpalosim mënyrën e marrjes së shtesave me qëllim që në të ardhmen shtesat për anëtarët e bordit të aprovohen nga Kuvendi i Kosovës dhe puna jashtë orarit të dokumentohet.</p>